



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 712 Prot.

Tiranë, më 03 / 05 / 2019

V E N D I M

Nr. 14 datë 03 . 05 . 2019

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË ANGAZHIMEVE TË AUDITIT PËR VITIN 2019 TË
SEKTORIT TË AUDITIT TË BRENDSHËM”**,

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Në zbatim të gjurmës ç), të nenit 12 si dhe gjurmës c) të nenit 14 të Ligjit Nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Vendimin Nr. 13, datë 17.11.2016, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe me propozimin e Sektorit të Auditit të Brendshëm me shkresë nr. 532 Prot., datë 28.03.2019, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kryerjes së angazhimeve të auditit për periudhën e mbetur të vitit 2019, në Strukturën Administrative të Rektoratit, Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave.
2. Ngarkohen Administratori i Institucionit, Struktura Administrative e Rektoratit, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, si dhe Sektori i Auditit të Brendshëm të UPT për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Alba Thoma

Arjan Beqiraj

Irida Vejsiu

Jonida Teta

Kryetar
Arben DHIMA

